
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NDËRMARRJA PUBLIKE BASHKIAKE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE

Nr. _____ prot.

Vlorë, më _____._____.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **TRANSPORT DHE TRAJTIM I LIXIVIAVEVE**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) : **50000000-5**

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,792,640 *(pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e dyzetë)* lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor *Ndërmarrja Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane* ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10.*

b. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën III.2.B – Me objekt të veprimtarisë “ Grumbullim dhe transport mbetjesh të rrezikëshme dhe jo të rrezikëshme”

Ne aktin e miratimit të licencës duhet të parashikohet që subjekti të administrojë mbetjet me kode 19 07 02 (rrjedhje nga landfillet që përmbajnë substanca të rrezikëshme) dhe 19 07 03 (rrjedhje nga landfillet të tjera nga ato të përmendura në 19 07 02)

Kriteri i pikës 2.1.1 është vendosur referuar nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikës 4.a të nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, VKM nr. 402 datë 30.6.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” dhe VKM nr.538, datë 26.05.2009 “ Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta ”

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisore III.I.C (leje tipi A) e cila duhet të mbulojë aktivitetet e mëposhtme :

- ID 5.2(a) – Landfill i mbetjeve (D1), me përjashtim të landfillit të mbetjeve inerte, sipas Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011, i ndryshuar;
- ID 5.3(e) – Asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme me metoda të tjera përveç (D1), (D8) ose (D9) ku të parashikohet që subjekti mund të trajtojë mbetjet me kode 19 07 02 dhe 19 07 03

Kriteri i pikës 2.1.2 është vendosur referuar nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikës 4.a të nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011 “ Për lejet e mjedisit ” i ndryshuar, VKM nr. 402 datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” dhe VKM nr.538, datë 26.05.2009 “ Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta ”

2.1.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me kodin unik të dorëzimit të mbetjeve të rrezikëshme.

Kriteri i pikës 2.1.3 është vendosur referuar ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, VKM nr. 402 datë 30.6.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2.c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43 pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2023, 2024 dhe 2025 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për përvojën e mëparëshme kërkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

ose

Ne rastin e parës se meparshme te realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen **vetëm** fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4.b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Të ketë në pronesi ose me qera një automjet për transport të vecantë (autobot) me kapacitet jo me pak se 30 m³, për të cilin duhet të paraqesë :

- Lejen e qarkullimi të automjetit;
- Taksat vjetore brenda afatit të vlefshmerisë;
- Policën e sigurimit të detyruar të automjetit (TPL) brenda afatit të vlefshmerisë;
- Certifikatë të Kontrollit Teknik të automjetit brenda afatit të vlefshmerisë.
- Certificate e miratimit ADR të automjetit;

Nëse mjeti është kompleks (tërheqës + gjysëmrimorkio) dokumentat e mësipërme duhet të paraqiten si për mjetin tërheqës (përveç certifikatës ADR) ashtu dhe për gjysëmrimorkion.

Ne se mjeti është me qera duhet të paraqesë përveç sa më sipër dhe Kontrate qeraje për automjetin, me kohëzgjatje brenda afatit të parashikuar të kryerjes së shërbimit.”

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4.ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Liksviatet (lëngje të ndotura që formohen kur uji i shiut, lagështia natyrore e mbetjeve dhe proceset e dekompozimit kalojnë përmes masës së mbetjeve në një landfill dhe shpërbëjnë ose marrin me vetë substanca të ndryshme ndotëse) janë të depozituara në vaskat e Landfillit dhe duhet të ngarkohen nga vaskat në një mjet për t’u transportuar drejt një impianti të specializuar për trajtimin e tyre.

Ngarkimi dhe transporti i tyre duhet të realizohet me mjet autobot ose mjet kompleks me gjysëmrimorkio bot. Duke qenë lëngje me nivel të lartë ndotje, mjetet për transportin e liksviateve dhe drejtuesit e këtyre mjeteve duhet të respektojnë kriteret për transportin e mallrave të rrezikshme. Duke qenë se diapazoni i boteve është relativisht i gjerë dhe përgjithësisht kapaciteti transportues i mjetit është në përpjestim të zhdrejtë me rrezikshmërinë e materialit që transportohet është parashikuar që kapaciteti i mjetit të transportit të jetë jo më pak se 30 m³ për të pasur një ekuilibër midis kostove të transportit, efikasitetit të shërbimit por dhe nivelit të rrezikshmërisë së transportit të këtyre lëngjeve.

Përdorimi i një autoboti me kapacitet minimal 30 m³ është i domosdoshëm për rritjen e efikasitetit operacional, pasi transporton një sasi më të madhe liksviati në çdo cikël pune, duke reduktuar

numrin e udhëtimeve, ul kohën e qëndrimit të liksiviatit në landfill, duke minimizuar rrezikun e tejmbushjes së rezervuarëve dhe derdhjeve aksidentale, redukton kostot operative, pasi nevojiten më pak udhëtime, më pak konsum karburanti, më pak orë pune dhe më pak konsum i mjeteve. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihet në dispozicion të paktën një mjet i përshtatshëm për të përmbushur kontratën dhe duke qenë se se objekt i kësaj procedure prokurimi është transporti i liksiviateve kërkohet plotësimi i kriterëve të nenit 12 të ligjit nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”

2.3.3 Te kete te punesuar drejtues mjeti per te cilet duhet te paraqese :

- Leje drejtimi te kategorise C (CE në rastin e mjetit kompleks) brenda afatit te vlefshmërise;
- Certificate Trajnimi ADR brenda afatit te vlefshmerise;
- Certificate te Aftesise Profesionale brenda afatit te vlefshmerise (CAP);
- Kontrate pune brenda afatit te vlefshmerisë.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikën 4.c të nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe nenin 38 të nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4 Subjekti duhet të ketë një të punësuar një staf prej të paktën 3 persona :

- | | |
|---|---|
| ○ Inxhinier Mjedisi ose Ekspert Mjedisor në rolin e Drejtuesit Teknik | 1 |
| ○ Operator impianti | 1 |
| ○ Specialist për sigurinë dhe shëndetin në punë | 1 |

Për Drejtuesin Teknik duhet të paraqiten :

- Diploma e arsimit të lartë
- Kontratë pune si Drejtues Teknik e cila duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë

për personelin tjetër, për secilin prej tyre duhet te paraqiten :

- Diplomë ose dëshmi të formimit profesional e lëshuar nga shkolla ose kurse të formimit profesional sipas Ligjit Nr.15/2017, “Mbi arsimin dhe formimin profesional, i ndryshuar.
- Kontratë pune ku të jetë specifikuar pozicioni i punës, brenda afatit të vlefshmerisë.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikave 4.b dhe 4.c të nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Trajtimi i liksivateve zakonisht kryhet në impiante të llojit Reverse Osmosis nëpërmjet kalimit të lëngut nëpër membrana të cilat largojnë pjesën më të madhe të elementëve ndotës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK, me qëllim sigurimin e AK se shërbimi i kërkuar, objekt prokurimi do të realizohet nga punonjës të kualifikuar për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Numri i punonjësve të kërkuar është përcaktuar duke u bazuar në natyrën e shërbimit, objekt prokurimi dhe proceset e punës në të cilat duhet të përmbushë ky shërbim.

Kërkesa për drejtuesin Teknik është bazuar në kërkasat e VKM nr.538, datë 26.05.2009 “ Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”

Trajtimi i liksiviatit përbën një proces me ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis. Liksiviati përmban përqendrimet të larta të lëndëve organike, azotit amoniakal, metaleve të rënda dhe ndotësve të tjerë që, nëse nuk trajtohen sipas parametrave teknikë, mund të shkaktojnë ndotje të tokës dhe ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore.

Prania e një Inxhinieri Mjedisore ose Eksperti Mjedisor është e domosdoshme për, organizimin teknik të procesit, monitorimin e funksionimit të implantit, mbikëqyrjen e parametrave të trajtimit, verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat mjedisore, hartimin e raporteve teknike dhe dokumentacionit për autoritetet kompetente, koordinimin e masave në rast emergjencash mjedisore.

Mungesa e këtij personeli mund të çojë në mosrespektimin e parametrave të trajtimit dhe krijimin e ndotjes mjedisore.

Operatorët e implantit të Reverse Osmosis janë parashikuar sepse duhet të realizojnë një sërë procesesh gjatë trajtimit të liksivateve në implant si monitorimi i parametrave të procesit, menaxhimi i kimikateve, marrja e mostrave etj.

Operatori është personi që kryen drejtpërdrejt funksionimin e implantit të trajtimit. Ai monitoron pompën, sistemet e filtrimit, pajisjet e dozimit të reagentëve, instrumentet e matjes dhe parametrat e procesit.

Pa operatorë të trajnuar ekziston rreziku i ndërprerjes së trajtimit dhe dëmtimit të implantit.

Specialisti për sigurinë dhe shëndetin në punë është kërkuar duke pasur parasysh natyrën e aktivitetit dhe rrezikshmërinë e punës në implantin e trajtimit të liksivateve, referuar kërkesave të ligjit nr.10 237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”

Procesi i transportit dhe trajtimit të liksiviatit përfshin, pajisje nën presion, pompa vakumi, energji elektrike, reagentë kimikë dhe rrezik biologjik dhe kimik.

Specialisti garanton hartimin e procedurave të sigurisë, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale, trajnimin e punonjësve dhe menaxhimin e emergjencave.

Mungesa e tij rrit ndjeshëm rrezikun e aksidenteve në punë.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i çertifikuar sipas standarteve :

- SSH EN ISO 9001:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente/ të barazvlefshme, brenda afatit të vlefshmërisë;
- SSH EN ISO 14001:2015 Sisteme të menaxhimit të mjedisit ose ekuivalente/ të barazvlefshme, brenda afatit të vlefshmërisë;
- SSH EN ISO 45001:2018 Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ose ekuivalente/ të barazvlefshme, brenda afatit të vlefshmërisë;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Standarti SSH EN ISO 9001:2015 " Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë" – Ky standard është i nevojshëm pasi ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të kërkuara , rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi do të përmbushë/realizojë shërbimet objekt prokurimi, sipas pritshmërive/specifikimeve teknike të kërkuara. Implementimi i këtij standarti ndihmon në optimizimin e burimeve dhe përmirësimin e efijencës së shërbimeve, duke ulur kostot dhe kohën e riparimit.

Standarti SSH EN ISO 14001:2015 " Mbi sistemet e menaxhimit të mjedisit" – është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që ky Standarti është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis, dhe në rastin konkret objekt i prokurimit janë shërbime realizimi i të cilave kërkon që ofertuesi të zbatojë politika të qëndrueshme mjedisore, duke zvogëluar ndotjen dhe ndikimin e dëmshëm në mjedis.

Standarti SSH ISO 45001:2018 "Mbi sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë" është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe me qëllim parandalimin/shmangien e çfarëdo rreziku, pasi shërbimet që do të kryhen përfshijnë një sërë rreziqesh për aksidente në punë, si dëmtime nga makineritë që do të përdoren për kryerjen e shërbimeve, lëndime nga kontaktet me kimikate toksike apo ndotëse, etj.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT

Kryetar -

Anëtar -

Anëtar -